

2016 RAPORT 2016 VJETOR



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

SKY TOWER

Rr. "Ibrahim Rugova"

Nr. 5, Ap 9/3

Tiranë, Shqipëri

Përgatitur nga: Sekretariati AAB-së

Design & Layout: FCB Afirma

Shtypi: Gentgrafik



Tabela e përmbajtjes:

Mesazh nga Kryetari.....	4
Organigrama.....	7
• Anëtarët e Bordit Drejtues.....	9
• Anëtarët e Asamblesë.....	11
• Sekretariati.....	12
• Komitete Teknike.....	12
• Anëtarësimet e Shoqatës.....	13
• Përmbledhje e vitit 2016.....	13
Sistemi Bankar në Shqipëri.....	14
• Fakte dhe Shifra.....	14
• Ndryshime Ligjore.....	15
• Rregullore të Bankës së Shqipërisë.....	16
Veprimtaritë.....	17
• Edukimi Financiar.....	17
• Trajnime.....	20
• Publikime.....	26
• Komitete Teknike.....	22
• Takime të tjera.....	34
• Evente.....	38
• Projekte.....	38
• Aktivitete Sociale.....	41
Bankat Anëtare / Fakte dhe Shifra.....	42
Pasqyra Financiare.....	44



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

MESAZH NGA KRYETARI

Që nga themelimi i AAB-së, bankat anëtare janë angazhuar ngushtë për përmbushjen e vizionit dhe misionit të AAB-së, duke synuar rritjen e bashkëpunimit mes bankave lokale përmes theksimit të rolit dhe kontributit të tyre në ekonominë vendase dhe në zhvillimin e shoqërisë. Gjithashtu, AAB gjithmonë ka synuar të mbështesë dhe të përmirësojë performancën e sektorit bankar në Shqipëri nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe konstruktiv të Bankës së Shqipërisë, duke mbështetur themelet e rritjes së ekonomisë në vend si dhe të shtyllave monetare dhe financiare.

Gjatë vitit 2016, përveç sfidave globale që lidhen me rritjen ekonomike, të cilat vijojnë të jenë të pranishme që nga kriza e vitit 2008, Shqipëria ka mbyllur një tjetër vit të suksesshëm duke shënuar një tendencë të lartë në rritjen e PBB-së dhe duke nxjerrë në pah mundësitë e pasqyruara falë reformave strukturore dhe zbatimit të rregullit të ligjit. Sektori bankar ka mbështetur fuqimisht zhvillimet ekonomike dhe reformat e projektuara për përmirësimin e klimës së biznesit dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare në vend. Në fund të Dhjetorit 2016, raporti i kredive me probleme arriti në vlerën 18.3 për qind, duke ruajtur të njëjtin nivel krahasuar me fundin e vitit 2015. Përtej ritmit të moderuar të rritjes së portofolit të kredisë dhe trajtimit të kredive me probleme që kanë prekur fitimet e vitit 2016, industria bankare sërish ruajti një pozicion të sigurt, të besueshëm dhe të qëndrueshëm, duke garantuar një mbështetje të konsiderueshme për rritjen ekonomike.

E nxitur nga roli dhe përgjegjësia e saj kyçe për garantimin e një kontributi efikas dhe konstruktiv për zhvillimin ekonomik dhe qëndrueshmërinë e sistemit bankar, AAB ka bërë përpjekje të vazhdueshme për krijimin e marrëdhënieve ndërvepruese me vendimmarrësit dhe ndikimin e palëve të interesit, me qëllim kryerjen e ndryshimeve të nevojshme ligjore për ekzekutimin e kolateralit dhe rolin e përmbauesve, ndërhyrjet e jashtëzakonshme të bankat, ligjin e falimentimit, kërkesat e sigurisë të zbatuara gjatë transportit të vlerave monetare (cash), ku disa vepra penale u shënuan edhe gjatë vitit 2016.

Revolucioni dixhital paraqet mundësi dhe sfida të mëdha për të gjithë aktorët e interesuar. Unë besoj fort se tashmë jemi në gjurmët e strategjisë së duhur dhe se





ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

bankat tona anëtare do të përballen dhe do t'i përqafojnë këto sfida dixhitale, duke përshtatur sistemet dhe politikat e tyre përkatëse që do të bëjnë të mundur që ata t'u ofrojnë klientëve të tyre një përvojë të shërbimeve bankare të thjeshta, miqësore, në kohë, të sigurta dhe pa probleme. AAB ka qenë pjesë e shumë diskutimeve të ndryshme në panele për rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me transformimet teknologjike në industrinë financiare dhe rëndësinë kritike të sigurisë kibernetike. Konferencat dhe forumet e shumta të organizuara përgjatë gjithë vitit, gjatë së cilave janë shtjelluar imtësisht këto tema, janë prova e qartësisht të situatës aktuale dhe tendencave të industrisë tonë bankare, të cilat nuk lënë pas progresin e arritur në ekonominë e zhvilluara. AAB, tepër e motivuar nga vizioni i saj për ofrimin e edukimit financiar të vazhdueshëm për punonjësit në banka, ka krijuar bashkëpunim të ngushtë me partnerë ndërkombëtarë dhe, për herë të parë në këtë kuadër, ka pajisur 16 bankierë me certifikata në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër krimeve financiare. Gjithashtu, vlen të përmendet se AAB ka marrë pjesë aktive në procesin e edukimit financiar të qytetarëve përmes eventeve të ndryshme të zhvilluara gjatë Javës Globale të Parasë. Vlejnë të përmenden botimet dhe artikujt e AAB-së, të cilat dhanë një kontribut të madh në edukimin financiar dhe fuqizimin e rolit të AAB-së në ekonomi.

Për të kuptuar rolin e medias në ndërgjegjësimin e publikut, AAB shënoi përmirësime të dukshme në zgjerimin e vizibilitetit së saj përmes një angazhimi më të mirë dhe pjesëmarrjes aktive në dialog. Reputacioni ynë është rritur ndjeshëm dhe slogani ynë "Bankat flasin me një zë" na përfaqëson në mënyrë të dukshme.

Arritjet e AAB-së i atribuohen shumë partnerëve në sukses. Në këtë drejtim, dëshiroj të falënderoj nga zemra anëtarët e Bordit të AAB-së, ish-anëtarët dhe anëtarët aktualë, për rolin e madh që kanë luajtur në përmbushjen e qëllimeve kyçe të AAB-së. Jam i bindur se gjatë viteve në vijim, ne do të jemi dëshmitarë të një faze të re rritjeje, zhvillimi dhe përparimi të mëtejshëm në sektorin bankar. Gjithashtu, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për përfaqësuesit e bankave dhe anëtarët e komiteteve për të gjitha kontributet, sugjerimet dhe informacionet e pasura dhe konstruktive që kanë dhënë në çështjet që lidhen me sektorin bankar dhe, së fundi, dëshiroj të shpreh falënderimet e mia të veçanta për Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së dhe stafin e saj për rolin kyç që ata kanë luajtur në përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të AAB-së.

Me shumë optimizëm dhe entuziazëm, shpresoj që kontributet e mëtejshme të AAB-së të shërbejnë sa më shumë në ruajtjen e qëndrueshmërisë së sektorit bankar dhe në mbështetjen e operacioneve të biznesit të bankave, të cilat do të materializohen në të tjera arritje të suksesshme në interesin më të mirë të ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare, punonjësve tanë dhe rrjedhimisht edhe të aksionarëve tanë.

Periklis DROUGKAS

KRYETAR

oob

Organigrama





ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



AAB

Anëtarët e Bordit Drejtues



Z. Periklis **DROUGKAS**
KRYETAR
Drejtor Ekzekutiv i
ALPHA BANK ALBANIA



Z. Silvio **PEDRAZZI**
ZËVENDËS KRYETAR
Drejtor Ekzekutiv i
INTESA SANPAOLO BANK
ALBANIA



Z. Dritan **MUSTAFA**
ANËTAR
Drejtor Ekzekutiv i
TIRANA BANK



Z. Andi **BALLTA**
ANËTAR
Drejtor Ekzekutiv i
AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS



Z. Frédéric **BLANC**
ANËTAR
Drejtor Ekzekutiv i
SOCIETE GENERALE ALBANIA



Z. Bozhidar **TODOROV**
ANËTAR
Drejtor Ekzekutiv i
FIBANK ALBANIA

MISIONI

“Zhvillimi, Qëndrueshmëria dhe Efikasiteti i Sektorit Bankar në Shqipëri”

AAB është një shoqatë jofitimprurëse, e cila synon të promovojë standardet më të fundit bankare të bankave të saj anëtare, si dhe zhvillimin, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit bankar në përgjithësi në Shqipëri, duke kontribuar kështu në progresin e ekonomisë shqiptare. AAB është një organ përfaqësues i krijuar për të dhënë kontributin e saj në formulimin e propozimeve legjislativë ose në komitetet teknike, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Shoqata Shqiptare e Bankave është përfaqësuese për 16 banka tregtare.

Anëtarët e Asamblesë


NR	BANKA	Asambleja e Anëtarëve
1	ALPHA BANK ALBANIA	Periklis DROUGKAS Drejtore i Përgjithshëm
2	AMERICAN BANK OF INVESTMENTS	Andi BALLTA Drejtore i Përgjithshëm
3	BANKA KOMBETARE TREGTARE	Seyhan PENCABLIGIL Drejtore i Përgjithshëm
4	CREDINS BANK	Maltin KORKUTI Drejtore i Përgjithshëm
5	CREDIT BANK OF ALBANIA	Sherine KAMEL Drejtore i Përgjithshëm
6	FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA	Bozhidar TODOROV Drejtore i Përgjithshëm
7	INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK	Gideon Van Den BROEK Drejtore i Përgjithshëm
8	INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA	Silvio PEDRAZZI Drejtore i Përgjithshëm
9	BANKA NBG ALBANIA	Ioannis AGATHOS Drejtore i Përgjithshëm
10	PROCREDIT BANK	Adela LEKA Drejtuese e Drejtorisë Ekzekutive
11	RAIFFEISEN BANK ALBANIA	Christian CANACARIS Drejtore i Përgjithshëm
12	SOCIETE GENERALE ALBANIA	Frederic BLANC Drejtore i Përgjithshëm
13	TIRANA BANK	Dritan MUSTAFA Drejtore i Përgjithshëm
14	UNION BANK	Gazmend KADRIU Drejtore i Përgjithshëm
15	UNITED BANK OF ALBANIA	Muhamed PRLJA Drejtore i Përgjithshëm
16	VENETO BANKA	Pierluigi CAFERRI Drejtore i Përgjithshëm

SEKRETARIATI

Sekretariati menaxhon veprimtaritë e përditshme të AAB-së dhe ofron një gamë të gjerë shërbimesh për anëtarët e Shoqatës. Këto shërbime përfshijnë: realizimin e planit të biznesit të miratuar nga Asambleja, koordinimin e komiteteve teknike, ndjekjen e çështjeve që lidhen përkatësisht me komitetet teknike, organizimin e konferencave, forumeve, programeve të edukimit financiar, kurseve të trajnimit, etj.

Sekretariati përcjell komunikime në emër të AAB-së, duke përfshirë botimet periodike, faqen e internetit të AAB-së, njoftimet për shtyp dhe artikujt për mediat sociale.

Sekretariati ofron mbështetjen e tij për organin e përzgjedhur që përfaqëson AAB-në, si zëri i vetëm i sektorit bankar.



- Aktualisht, Z. Spiro Brumbulli është emëruar Sekretar i Përgjithshëm i AAB-së.



Komitetet Teknike

(Dhjetor 2016)

KOMITETI

- » **Komiteti i Sigurisë së Bankës**
- » **Komiteti i Kartave**
- » **Komiteti i Përputhshmërisë**
- » **Komiteti i Burimeve Njerëzore**
- » **Komiteti i Sigurisë së Informacionit**
- » **Komiteti i Auditit të Brendshëm**
- » **Komiteti Ligjor**
- » **Komiteti i Marrëdhënieve me Publikun**
- » **Komiteti i Sistemeve të Pagesave**
- » **Komiteti i Thesarit dhe Tregut Financiar**

KRYETARI

- Roland Tashi
- Imelda Koçaj
- Ndue Maluta
- Valbona Zeneli
- Akil Ndrenika
- Dorida Stambolla
- Veronika Prifti
- Viola Smaja
- Najada Xhaxha
- Erion Taçe

ANËTARËSIMET E SHOQATËS

AAB është përkatësisht anëtare, anëtare e asociuar ose partnere në organizatat e mëposhtme kombëtare/ndërkombëtare.

Anëtarësimet Ndërkombëtare:

- Federata Evropiane e Bankave (EBF)
- Forumi i Shoqatave të Bankave INTERBALKAN
- Shoqata e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE)
- Rrjeti Ndërkombëtar i OECD për Edukimin Financiar (INFE)
- Shoqata Evropiane e Trajnimeve Bankare & Shërbime Financiare (EBTN)
- Agjencia e Transferimit të Teknologjisë Financiare (ATTF)

Anëtarësime Kombëtare:

- Këshilli Ekonomik Kombëtar
- Këshilli Tatimor
- Këshilli Ekonomik i Bashkisë së Tiranës
- ICC Albania
- Këshilli Kombëtar i Punës
- Komiteti i Sistemit Kombëtar të Pagesave

Përmbledhje e vitit 2016

- » Asambleja e Anëtarëve zhvilloi 3 mbledhje të njëpasnjëshme gjatë vitit 2016.
- » Komiteti Ekzekutiv zhvilloi 5 mbledhje të njëpasnjëshme gjatë vitit 2016.
- » Z. Spiro Brumbulli u emërua Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave (Prill 2016).
- » Gjatë takimit të zhvilluar në Dhjetor 2016, Asambleja emëroi Z. Periklis Drougkas, Drejtor Ekzekutiv i Alpha Bank Albania, në pozicionin e Kryetarit të ri të AAB-së dhe Z. Silvio Pedrazzi, Drejtor Ekzekutiv i Intesa Sanpaolo Bank Albania, si Zëvendëskryetarin e ri të AAB-së.
- » Më 30 Nëntor 2016, përfaqësuesit e Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) dhe të Shoqatës së Bankave Malazeze (AMB) nënshkruan një Memorandum për Partneritet dhe Bashkëpunim.

SISTEMI BANKAR NË SHQIPËRI

Fakte dhe Shifra

- **Urdhër-pagesat e standardizuara**

- Në Maj 2016, u zhvillua konferenca e parë **"Bankingu digjital në Shqipëri"**, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe Komitetin e Sistemit Kombëtar të Pagesave.
- Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi, sipas të cilit institucionet nënshkruese angazhohen të ndërmarrin masa konkrete për nxitjen e rritjes së qëndrueshme të kredive.
- Gjatë vitit 2016, **portofoli i kredisë në lekë** ndaj sektorit privat u rrit me 10.2%, ndërsa totali i kredive u rrit me 3.2%.
- **Stoku i depozitave**, në fund të Dhjetorit, **u vlerësua rreth 4.9% më i lartë** në terma vjetorë, duke përbërë rreth 73.7% të PBB-së, ose rreth 1.1 përqind më i lartë krahasuar me një vit më parë.
- U vlerësua një performancë e mirë e **depozitave për familje dhe për biznes**, me një rritje mesatare vjetore prej 1.9% dhe 7.6%, përkatësisht.
- Në fund të vitit 2016, **pjesa e aktiveve në sektorin bankar u vlerësua me 95.8%** të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), duke shënuar një rritje prej 4.5 përqind krahasuar me vitin e kaluar.
- **Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit** qëndroi në vlerën 15.7%.
- Në Dhjetor 2016, **treguesit e likuiditetit**, të shprehur si raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve dhe raporti i aktiveve të likuiditetit ndaj pasiveve afatshkurtra shënuan përkatësisht **31.3%** dhe **40.6%**.
- Në fund të vitit 2016, 14 nga 16 banka ofronin **produkte të ndryshme bankare në distancë**. (Këto produkte ofrojnë akses në distancë në llogarinë bankare, nëpërmjet instrumenteve me internet, telefonit ose përmes softuerëve të vendosur në dispozicion nga banka për klientët e saj.)
- Për rrjedhojë, u vërejt një rritje e ndjeshme prej **27.63% e volumit të pagesave në distancë** dhe një rritje prej 21.51% e vlerës së transaksioneve, krahasuar me vitin e mëparshëm.
- Normat e interesit të aplikuara për **kreditë në lekë në sektorin privat jo financiar** shënuan mesatarisht **7.52%**, krahasuar me 8.07% në vitin 2015.
- Trendi mesatar i treguesve të rentabilitetit të sektorit bankar konfirmon se ecuria e kthimit nga aktivet (**RoA**) shënoi **0.7%** ndërsa ecuria e kthimit nga kapitali (**RoE**) shënoi **7.2%**.
- Në dhjetor 2016, **kreditë me probleme llogariten në nivelin 18.3%** të portofolit të kredive, duke ruajtur pothuajse të njëjtin raport me një vit më parë.

Ndryshime Ligjore

Ndryshimet në Ligjin “Për Barrët Siguruese”

Më 20 tetor 2016, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 101/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguruese” i ndryshuar” (në vijim referuar si Ligji për Barrët Siguruese). Pas disa ndryshimeve të prezantuara me Ligjin për Barrët Siguruese në maj 2013 (në bazë të Ligjit nr. 132/2013), “pasuritë e patundshme”, “instrumentet”, “titujt” dhe “llogaritë” nuk mund të lëshohen më si kolateral. Pas disa përpjekjeve të shumta të ndërmarra nga industria bankare, organet legjislative vendosën përsëri barrën siguruese mbi pasuritë e paluajtshme, duke u dhënë kështu kreditorëve më shumë opsione për të zgjedhur llojin e sigurisë që u përshtatet më mirë.

Ndryshimet në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”

Ligji i ri nr. 131/2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9962, datë 18.12.2006 Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, u botua në Fletoren Zyrtare Shqiptare më 11 janar 2017 dhe hyri në fuqi 6 muaj pas datës së botimit të tij zyrtar. Ndryshimet e reja në Ligjin për Bankat nuk priten të ndikojnë në mënyrë thelbësore te subjektet që janë objekt i këtij ligji, pasi qëllimi kryesor i këtyre ndryshimeve ka qenë përputhshmëria me Ligjin e ri nr. 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”, çka shkaktoi shfuqizimin e disa instrumenteve ligjore të cilat rrjedhimisht do të përfshiheshin në ligjin e fundit.

Ligji i ri “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”

Parlamenti shqiptar miratoi Ligjin nr. 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”. Ligji është përafuar pjesërisht me Direktivën 2014/59/BE, datë 15 maj 2014 (Direktiva për Rikuperimin dhe Rezolutën e Bankave - BRRD). Ligji i ri synon të vendosë një bazë të qartë ligjore, të përcaktojë kriteret, procedurat, treguesit dhe veçanërisht rolin e institucioneve të përfshira në rikuperimin dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, kur këto të fundit po përballen me një krizë të rëndë financiare. Për rrjedhojë, ky ligj vendosi në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për ndërhyrje të jashtëzakonshme, një sërë instrumentesh ligjore për të ndërhyrë në një fazë mjaftueshëm të hershme, në rastin kur një bankë është në prag të kolapsit, duke garantuar vazhdimësinë e funksionimit financiar dhe ekonomik që është thelbësore për bankën dhe duke minimizuar kështu efektin që kolapsi i një banke të caktuar mund të shkaktojë mbi sistemin financiar dhe ekonominë e vendit në tërësi.

Ligji i ri për Falimentimin

Më 27 tetor 2016, Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin nr. 110/2016 “Për Falimentimin”. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të përbashkëta detyruese për të lehtësuar zgjidhjen dhe shlyerjen e detyrimeve të debitorit sipas procedurës së falimentimit dhe/ose jashtë kësaj procedure. Ndryshe nga ligji i mëparshëm, projektligji i ri përfshin një nënkapitull me përkufizime që përcaktojnë kushtet që shërbejnë vetëm për qëllimet e këtij ligji. Një nga risitë kryesore të këtij projektligji të ri është vendosja e prioriteteve të reja për shlyerjen e detyrimeve para dhe pas shpërndarjes.

SISTEMI BANKAR NË SHQIPËRI

Ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile

Një tjetër projektligj i ri për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile po shqyrtohet nga Komisionet Parlamentare Shqiptare. Disa nga ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile synojnë të harmonizojnë dispozitat ekzistuese me projektligjin e ri për falimentimin. Duke marrë në konsideratë ndryshimet e propozuara, një nga detyrat e tjera të caktuara sektorëve të veçantë të krijuar në gjykatat e qarkut për këto lloj mosmarrëveshjesh, duke përfshirë këtu, ndër të tjera, edhe mosmarrëveshjet tregtare, janë gjithashtu edhe zgjidhjet e mosmarrëveshjeve në rastet e falimentimit.

Ndryshimet kryesore të Kodit të Procedurës Civile lidhen me procedurat e detyrueshme të ekzekutimit. Pritet të jepen më shumë sqarime në lidhje me urdhrin ekzekutiv të lëshuar nga gjykata, llogaritjen e interesit të vonuar të pagesës, rregullat për pagesën e taksës së përmbartimit mbi titujt ekzekutiv, vlerësimin e vlerës së objekteve të sekuestruara, etj. Një nga ndryshimet më të rëndësishme është vendosja e një afati statusor kufizimi brenda të cilit debitori mund të depozitojë në gjykatë një kërkesë ku pretendon deklarimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv ose në të kundërt shfuqizimin ose fshirjen e këtij detyrimi.

Rregullore të Bankës së Shqipërisë

Shkurt - Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përmes Vendimit Nr. 15, datë 03.02.2016, ka kryer rishikimin e Rregullores "Për dhënien e licencës dhe ushtrimin e veprimtarisë bankare të bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë". Këto rishikime u kryen për të garantuar përputhshmërinë dhe qëndrueshmërinë me konceptet e aplikuara në dokumentin e Politikës së Mbikëqyrjes.

Mars - Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi Vendimin nr. 50, datë 30.03.2016 "Për disa ndryshime në Rregulloren nr. 62, datë 14.09.2011 "Për administrimin e riskut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja". Qëllimi i kësaj rregulloreje është: a) të përcaktojë rregullat për menaxhimin e riskut të kredisë në veprimtarinë e bankave dhe të degëve të bankave të huaja, dhe b) të përcaktojë kriteret për vlerësimin e riskut të kredisë dhe klasifikimin e huave dhe aktiveve, si dhe të llogarisë rezervat për provigjionet nga humbjet e kredisë të shkaktuara nga zhvlerësimi i tyre.

Mars - Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me Vendimet nr. 49 dhe 50, datë 30.03.2016, rishikoi përkatësisht rregulloret "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" dhe "Për administrimin e riskut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja". Këto rregullore u ndryshuan në të njëjtën kohë, duke marrë në konsideratë angazhimet e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në planin e masave për zvogëlimin e kredive me probleme.

Qershor - Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi Vendimin nr. 67, datë 01.06.2016 "Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet ku kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare dhe për transportin e vlerave monetare". Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale të sigurisë lidhur me ambientet ku kryhen veprimtaritë bankare dhe/ose financiare dhe për transportin e vlerave monetare, për mbarëvajtjen normale dhe të sigurt të këtyre veprimtarive.

AKTIVITETE

Edukimi Financiar

Një pjesë thelbësore e misionit të AAB-së është informimi i publikut të gjerë dhe rritja e ndërgjegjësimit për çështjet financiare, duke edukuar klientët të marrin vendime financiare të mirë-informuara. Për këto arsye, ne e kemi kthyer edukimin financiar në një komponent të rëndësishëm të punës sonë.

AAB ka ndërmarrë disa iniciativa edukimi përgjatë gjithë vitit, e megjithatë, këto iniciativa fillestare do të vazhdojnë të zgjerohen edhe më tej.

Forumi Financiar: Eseja më e mirë



Më 26 maj, Departamenti i Financës pranë Universitetit Evropian të Tiranës (UET) organizoi Forumin Vjetor të studentëve që janë pjesë e këtij departamenti. Gjatë këtij forumi, u prezantuan disa ese me tema që lidhen me bankat dhe financat. Forumi u organizua në formën e një konkursi, ku Komisioni ndau çmime për 3 prezantime. Këtë vit, fituesi i dytë i "Forumit Financiar: Çmimi "Eseja më e mirë" u dha nga AAB.

Konferenca e Dytë Kombëtare për "Sfidat e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë"

Më 27 maj, Departamenti i Financave pranë Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tiranës organizoi Konferencën e Dytë Kombëtare për "Sfidat e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë". Këtij aktiviteti iu bashkuan pjesëmarrës nga fusha të ndryshme të kërkimit shkencor, studentë dhe ekspertë të ekonomisë, me synim dhënien e një kontributi konkret për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe financiar. Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, gjatë fjalimit të tij u përqendrua në rëndësinë e Edukimit Financiar dhe shprehu mirënjohjen për ekipin e Fakultetit Ekonomik, i cili ishte një nga pjesëmarrësit dhe fitoi vendin e parë në një nga konkurset e organizuara gjatë Javës së Parës.

Lider për 1 Ditë

Në 23 mars, AAB iu bashkua eventit të organizuar nga Junior Achievement Albania (JA). Gjatë ditës së këtij eventi, AAB mirëpriti një nxënës të shkollës së mesme, i cili ndoqi axhendën e Sekretarit të Përgjithshëm në të gjitha takimet e planifikuara gjatë ditës së punës. Studenti u njoh me stafin që punon me drejtuesin dhe gjithashtu atij iu dha një përmbledhje e strukturës organizative të institucionit pritës.

AKTIVITETE

Java e Parasë, 14-18 mars 2016

Organizatat Lider të Shqipërisë: Banka e Shqipërisë (BSH), Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB).

Numri i organizatave pjesëmarrëse: 21

Numri i fëmijëve të kontaktuar: 13 000

Numri i veprimtarive: 16

Ceremonia e hapjes së Javës Globale të Parasë në Shqipëri u mbajt më **14 mars**, me pjesëmarrjen e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Ministrin të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrin të Arsimit dhe Kryetarit të Shoqatës Shqiptare të Bankave. Ky aktivitet u linçua në parkun pranë ndërtesës së BSH. Pas ceremonisë, në park u zhvilluan disa veprimtari edukative dhe argëtuese të projektuara për fëmijë. Gjithashtu, këtyre fëmijëve iu dhuruan kuti kursimi në formë derrkuci të stampuara me sloganin e Javës së Parasë.

Të martën, më **15 mars**, Banka e Shqipërisë organizoi një tryezë të rumbullakët me temë "Nevoja për një Strategji Kombëtare për Edukimin Financiar", e cila u organizua bashkërisht me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të AAB-së, Institutit të Zhvillimit të Arsimit, Agjencisë Kombëtare të Arsimit Profesional, Trajnimit dhe Kualifikimeve, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, Agjencisë Shqiptare të Depozitave të Sigurimeve dhe Ministrisë së Ekonomisë, së bashku me studentët e ekselencës, personalitete dhe ekspertë nga ky sektor (profesorë dhe organizata jofitimprurëse).

Leksion i hapur i organizuar në Universitetin e Elbasanit nga ekspertë të FIBank dhe Bankës së Shqipërisë.

Të mërkurën, më **16 mars**, u organizua debati sipas formatit Karl Popper mes gjashtë ekipeve nga tre universitetet kryesore shqiptare me fokus të veçantë në temën "A duhet të jetë edukimi financiar pjesë e kurrikulës së detyrueshme para-universitare? (Avantazhet/Disavantazhet)". Ky event u organizua nga AAB dhe u zhvillua në ambientet e Qendrës Rinore të Tiranës.

Nxënësit e shkollave të mesme vizituan një degë të bankës për t'u njohur nga afër me veprimtaritë e saj kryesore operationale.

Të enjten, më **17 mars**, një tjetër dialog në tryezë



të rrumbullakët u zhvillua lidhur me “Edukimin Financiar dhe Sipërmarrjen”, i fokusuar në diskutime për sipërmarrësit e rinj dhe suksesin ekonomik, kompetencat sipërmarrëse, elasticitetin financiar dhe përvojat praktike të biznesit. Ky event u organizua në bashkëpunim me Junior Achievement Albania, AAB-në dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Organizimi i një trajnimit të zhvilluar në Qendrën Rinore në Tiranë, i projektuar për sipërmarrësit e rinj dhe organizatat e shoqërisë civile lidhur me hartimin e “Buxhetit”.

Leksion i hapur i organizuar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës nga ekspertë nga Banka Credins dhe Banka e Shqipërisë.

Të premten, më **18 mars**, në Universitetin e Studimeve të Integruara, Durrës u zhvillua Konkursi “Të sillemi si bankierë”.

Në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, u organizuan leksione të hapura të mbajtura nga ekspertë të Alpha Bank, Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Në Universitetin e Korçës, u mbajtën leksione të hapura nga ekspertë të Union Bank dhe Bankës së Shqipërisë.

Nxënësit e shkollave fillore vizituan një degë të bankës me qëllim që të njihen për herë të parë me bankën.

Gjatë gjithë javës, janë organizuar mjaft evente të tjera emocionuese dhe interesante për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri, duke përfshirë: Vizitat e nxënësve të shkollave në Muzeun e BSH-së; konkursi ndërmjet tre shkollave të mesme të cilat kanë përzgjedhur lëndën me zgjedhje “Financat personale në duart tuaja”, i cili u transmetua në “Scan TV”; trajnim i studentëve lidhur me skemën e sigurimeve shoqërore.

Gjithashtu, Java Globale e Parasë u mbulua gjerësisht nga mediat dhe shtypi vendas, duke transmetuar reklama dhe promovime në mediat sociale dhe në radio, si dhe intervista në televizion dhe artikuj të publikuar në shtypin e ditës. Gjatë kësaj Jave, në emisionin “Artistët e vegjël” në kanalin televiziv Çufo në platformën Digitalb u ekspozuan krijime grafike artistike të shumta lidhur me aspekte të ndryshme të parave të projektuara për fëmijë.



TRAJNIME

Gjatë vitit 2016:

U organizuan
23 trajnime
të brendshme

U
bashkëpunua
me **12**
partnerë

Morën pjesë
346
punonjës



Të mësuarit dhe zhvillimi është një nga shtyllat themelore të AAB-së. Funkzioni i AAB-së për ngritjen e kapaciteteve është rritur ndjeshëm. Gjatë këtyre viteve të fundit, kemi organizuar trajnime gjithnjë e më profesionale brenda vendit, të ofruara nga ekspertët më të mirë ndërkombëtarë. Ne e kemi zgjeruar më tej bashkëpunimin e shkëlqyer me partnerët tanë të trajnimit dhe gjithashtu kemi mirëpritur edhe bashkëpunime të reja profesionale. Për herë të parë këtë vit ofruam një program trajnimi të certifikuar me mbështetjen e partnerit tonë kryesor ndërkombëtar "Qendra e Trajnimeve Luksemburg" (ATTF).

Janar

Data: 25-29 janar

Tema: Menaxhimi i Projekteve - Niveli i Avancuar

Nr. i pjesëmarrësve: 9 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Dynact Austria/Alexander Kagl, Partner i Lartë Drejtues i Dynact dhe President i PMI Austria



Data: 26 janar

Tema: Përkrahja e punonjësve nëpërmjet Ndryshimeve Organizative në Sektorin Bankar.

Nr. i pjesëmarrësve: 11 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Dr. Leslie Szamosi, Drejtore Akadematike Ekzekutive e MBA dhe lektore titullare e MBNJ në Fakultetin Ndërkombëtar të Universitetit të Sheffield.



TRAJNIME

Shkurt

Data: 8-9 shkurt

Tema: Zbulimi dhe Parandalimi i Mashtrimeve

Nr. i pjesëmarrësve: 20 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Instituti Grek i Bankave / Kostas Triantafyllidis, trajner ndërkombëtar dhe anëtar bordi i Institutit Grek të Auditorëve të Brendshëm



Data: 16 shkurt

Tema: Seminar Rajonal për një zbatim më të mirë të kuadrit rregullator të Luftës kundër Pastrimit të Parave

Nr. i pjesëmarrësve: 42 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: AAB dhe Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP), Ndue Maluta, anëtar i Kryesisë së Komitetit të Përputhshmërisë së AAB-së dhe Kryetar i Grupit të Riskut në BKT dhe përfaqësues i DPPPP.



Data: 24-26 shkurt

Tema: Bankat për Individë dhe Kanalet e reja të Shpërndarjes

Nr. i pjesëmarrësve: 27 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Qendra e trajnimeve në Luksemburg/ Pierre Voos, Sekretari i Përgjithshëm, Përgjegjës për Menaxhimin e Strategjisë, Projekteve dhe Produkteve, ING Luksemburg, Ekspert Zyrtar i Lartë i ATTF-së.



Mars

Data: 10-11 mars

Tema: Negociatat Win-Win

Nr. i pjesëmarrësve: 5 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Qendrat Lincoln në Shqipëri, David Turner



Data: 15-16 mars

Tema: Inteligjenca emocionale

Nr. i pjesëmarrësve: 12 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: WIFI Albania, Larissa Winter



Data: 17-18 mars

Tema: Menaxho energjinë tënde, jo kohën

Nr. i pjesëmarrësve: 10 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: WIFI Albania, Larissa Winter



Data: 23-24 mars

Tema: Bankat në Marrëdhëniet me Klientin

Nr. i pjesëmarrësve: 10 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Paul Gauci

Data: 25 mars

Tema: Menaxhimi i Riskut të Likuiditetit të Bankës sipas kuadrit Bazel III dhe Direktivës IV për Kërkesat e Kapitalit (CRD4)

Nr. i pjesëmarrësve: 19 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: IFC, Victor Hill, Ekspert Ndërkombëtar

Prill

Data: 20-21 prill

Tema: Menaxhimi i Riskut për Profesionistët e Riskut dhe të Auditit të Brendshëm

Nr. i pjesëmarrësve: 16 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Instituti Shqiptar i Auditorëve të Brendshëm (ISHAB)

Maj

Data: 25-27 maj

Tema: Trajnim për Trajnuesit: Didaktika dhe Metodologjia

Nr. i pjesëmarrësve: 10 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Instituti Austriak i Ekselencës

Data: 27-28 maj

Tema: Trajnim për Shitjet dhe Negocimin

Nr. i pjesëmarrësve: 14 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Instituti Austriak i Ekselencës, Eric Molin, ekspert i trajnimeve për komunikimin

Qershor

Data: 15 qershor

Tema: Seminar për Riskun Operacional dhe Krimin Financiar

Nr. i pjesëmarrësve: 19 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: IFC, ekspertë të IFC-së



TRAJNIME

Shtator

Data: 20 shtator

Tema: Inteligjenca Emocionale në punë

Nr. i pjesëmarrësve: 6 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: David Turner, trajner ndërkombëtar



Data: 22 shtator

Tema: Seminar "Për Sigurinë e Informacionit"

Nr. i pjesëmarrësve: 14 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Nicola Gordon, Menaxher Rajonal për Tregjet në Zhvillim me MarkMonitor (pjesë e Thomson Reuters).



Data: 29-30 shtator

Tema: Drejtimi Strategjik dhe Qeverisja Efektive

Nr. i pjesëmarrësve: 12 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Instituti Austriak i Ekselencës, Larissa Winter



Tetor

Data: 11-13 tetor

Tema: NVM: nga plani i biznesit te financimi bankar

Nr. i pjesëmarrësve: 27 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: ATTF Luksemburg



Data: 26-27 tetor

Tema: Negociatat Win-Win

Nr. i pjesëmarrësve: 6 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Qendrat Lincoln në Shqipëri, David Turner



Data: 31 tetor - 04 Nëntor

Tema: Menaxhimi i Aplikuar i Riskut në Bankë

Nr. i pjesëmarrësve: 20 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: ATTF Luksemburg, Stefano Bragoli, Anëtar i Qendrës së Trajnimit në Departamentin e Cilësisë ALRiM për Menaxhimin e Riskut



Nëntor

Data: 7 nëntor

Tema: Të investosh me UBS

Nr. i pjesëmarrësve: 11 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: ICC Albania



Dhjetor

Data: 5-9 dhjetor

Tema: Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML & CTF) në nivel fondacioni

Nr. i pjesëmarrësve: 16 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Qendra e trajnimeve, Luksemburg



Data: 12 dhjetor

Tema: Ndërtimi i ekipeve me performancë të lartë përmes bashkëpunimit

Nr. i pjesëmarrësve: 11 përfaqësues të bankave anëtare

Partner për trajnimin/Trajner: Mark Engelhardt, trajner



AAB - Qendra e Trajnimeve (ATTF Luksemburg)

Falë bashkëpunimit të AAB-së me Qendrën e Trajnimeve në Luksemburg që nga viti 2014, bankierët shqiptarë kanë marrë pjesë në trajnime certifikimi të cilësisë së lartë të ofruara nga Agjencia e Transferimit të Teknologjisë Financiare në Luksemburg (ATTF) të zhvilluara në Luksemburg, në bashkëpunim edhe me organizma të tjerë ndërkombëtarë. Kjo përbën një mundësi shumë të mirë për t'u ardhur në ndihmë trajnimeve të vazhdueshme profesionale në mbështetje të zhvillimit të tyre personal dhe profesional, si dhe për të nxitur frymën e sipërmarrjes.

Mbi 20 pjesëmarrës aplikuan nga Shqipëria dhe shumica prej tyre morën pjesë në 15 trajnime profesionale të organizuara në Luksemburg, ku përfituan nga ekspertiza financiare e Luksemburgut.

ATTF ka krijuar kontakte me AAB-në për ngritjen, ruajtjen dhe ofrimin e burimeve cilësore të mësimin dhe për transferimin e njohurive teknike që i përshtaten nevojave të Tregut Financiar Shqiptar.

BOTIME

Publikimet e AAB-së ndahen në dy kategori kryesore: periodike dhe jo periodike, d.m.th. njoftime për shtyp ose artikuj të tjerë me shkrim që botohen në raste të veçanta për të informuar mediat dhe publikun. Nëpërmjet raporteve vjetore, revistave, buletineve dhe videove informative, AAB ofron burimet e duhura për të informuar publikun mbi zhvillimet në sistemin bankar në përgjithësi, çështjet problematike dhe veprimtaritë e ndërmarra nga Shoqata. Hartimi (forma dhe përmbajtja) dhe shpërndarja e komunikimeve me shkrim ndiqet nga Sekretariati i AAB-së.

Raporti CSR 2015 - Bankat për Shoqërinë

Për të dytin vit radhazi, ABB botoi "Raportin CSR 2015 - Bankat për Shoqërinë". Për herë të parë, ky publikim synon të ofrojë një pasqyrë të veprimtarive të bankave në kontekstin e CSR, në përputhje me 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të miratuara në vitin 2015 nga Kombet e Bashkuara, 15 prej të cilave janë klasifikuar si veprimtari sociale të ndërmarra nga Bankat, edhe pse Axbenda e 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm u miratua më 25 shtator 2015.

Raporti vjetor 2015

Raporti Vjetor i AAB-së, i botuar në korrik të këtij viti, përfshin zhvillimet dhe veprimtaritë kryesore të Shoqatës gjatë vitit 2015.

Revista "Bankieri"

Botimet me numër 18, 19, 20 dhe 21 të revistës "Bankieri" u botuan përkatësisht në janar, prill, korrik dhe tetor. Revista mund të shkarkohet nga interneti dhe është e disponueshme online në rrjetet sociale, si dhe është shpërndarë gjithashtu edhe në kopje të shtypura për të gjitha palët e interesuara.



Statistika

AAB publikon raporte tremujore financiare të pa audituara të bankave tregtare të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) dhe në të dhënat mujore të grumbulluara për sistemin.

Buletine mujore

Buletini mujor i hartuar nga Sekretariati i AAB-së i është dërguar të gjitha palëve si në nivel drejtues ashtu edhe në nivel të lartë. Ai përfshin informacione mbi zhvillimet e reja dhe përditësimet e veprimtarive të AAB-së.

Video

AAB vijoi botimin e videove të tjera informative pasuese të serisë "Banka ime" mbi Edukimin Financiar:

- Kartat e Bankave
- Kreditë me norma të ndryshueshme
- Mbroni postën elektronike
- Mbroni identitetin tuaj në internet
- Mbroni telefonin tuaj celular



KOMITETE TEKNIKE

11 Komitetet tona të përfshira në raportin vjetor të AAB-së i orientojnë përpjekjet tona të përbashkëta drejt diskutimit dhe shkëmbimit të përvojave dhe problematikave për çështjet operacionale dhe legjislative, me qëllim përmbushjen e objektivave specifike. Komitetet Teknike zhvilluan **mbi 50 takime** gjatë vitit 2016 dhe më pas çështjet e identifikuara nga këto Komitete u ndoqën më tej nga Sekretariati i AAB-së.

Këtë vit, Sekretariati i AAB-së organizoi një takim të veçantë me kryetarët e të gjitha Komiteteve Teknike. Në këtë takim të parë të këtij lloji, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së bëri thirrje për përfundimin e partneritetit mes komiteteve, duke synuar rritjen e imazhit pozitiv të sistemit bankar dhe të qenit më aktiv në fushën e edukimit financiar.

Komiteti i Sigurisë së Bankës

Anëtarët e Komitetit zhvilluan disa takime gjatë këtij viti. Gjatë tremujorit të parë, Sekretariati i AAB-së dhe stafi i saj drejtues u angazhuan intensivisht në takime me Drejtorin e Përgjithshëm të Sigurisë Publike të Policisë së Shtetit. Së bashku, ata trajtuan kryesisht çështjet që lidhen me sigurinë e ofruar gjatë transportit të vlerave monetare dhe me Udhëzimin e Ministrit që rregullon dhe përcakton standardet që duhet të ndiqen nga Shoqëritë Private të Sigurisë për transportin e vlerave monetare.

Më pas, anëtarët e Komitetit u bënë pjesë e grupit të punës të ngritur në Policinë e Shtetit me fokus në rishikimin e udhëzimit "Për funksionet e shërbimeve private të sigurisë fizike dhe të qendrës private të trajnimit". Komentet e mbledhura nga ky sektor të hartuara nga Sekretariati i AAB iu dërguan Policisë së Shtetit në Prill të vitit 2016.

Një tjetër kontribut i vlefshëm i këtij Komiteti gjatë këtij viti është ai lidhur me rregulloren e rishikuar "Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet ku kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare" e dërguar nga Banka e Shqipërisë, e cila përcakton kërkesat minimale të nevojshme të sigurisë në ambientet e bankës. Anëtarët e Komitetit dhe Sekretariati i AAB-së dhanë të gjitha komentet dhe sugjerimet e tyre përkatëse për këtë sektor, të bashkërenduara në një material të vetëm, i cili iu dërgua në kohë Bankës së Shqipërisë. Kjo e fundit

përfshiu shumicën e këtyre vërejtjeve dhe sugjerimeve në materialin përfundimtar, i cili më pas u miratua nga Bordi Mbikëqyrës. Në axhendën e Komitetit për tremujorin e dytë dhe të tretë u përfshinë çështje të ndryshme lidhur me zbatimin e kontratave të lidhura me shoqëritë private të sigurimit, vështirësitë e hasura për marrjen e licencës nga Akademia e Policisë së Shtetit për përdorimin e armëve të zjarrit nga punonjësit e tyre dhe pajisjet e përdorura nga punonjësit e shoqërive private të sigurisë të shoqëruara me një certifikatë për "aftësitë teorike dhe praktike për përdorimin e armëve të zjarrit". Komiteti zhvilloi takime të ndryshme të përbashkëta me Policinë e Shtetit dhe Shoqatën e Shërbimit të Sigurisë Private për të diskutuar lidhur me zgjidhje të ndryshme, duke marrë në konsideratë ekzistencën e boshllëqeve ligjore.

Pas grabitjes që ndodhi në Aeroportin Ndërkombëtar të Shqipërisë, Komiteti i Sigurisë së Bankave dhe Sekretariati i AAB-së u takuan me Drejtorin e Aeroportit Nënë Tereza dhe stafin e saj për të trajtuar shqetësimet në fjalë dhe për të sugjeruar rritjen e masave të sigurisë. Vëmendje e veçantë iu kushtua sigurisë në aeroport gjatë procesit të transportit të vlerave monetare, ndërtimit të një zone të veçantë ngarkimi për bankat tregtare si dhe ndërtimi i një zone të mbrojtur ngarkimi dhe lëvizja e sigurt në portën e hyrjes brenda territorit të Aeroportit.

Gjatë tremujorit të fundit, axhenda e Komitetit u përqendrua në shkëmbimin e përvojave mes anëtarëve lidhur me zbatimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë” si dhe elementët e inspektimeve të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në banka të ndryshme, ligji i ri “Për masat shpeshë për sigurinë publike” dhe përfitimet që sjell ndërtimi i një qendre të operacioneve të sigurisë.

Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së dhe Kryetari i Komitetit ndoqën me kujdes çështjen e masave të sigurisë së lartë për transportin e vlerave monetare brenda ose jashtë ambienteve të aeroportit. Gjatë takimit të fundit për këtë vit, Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil u zotua se një nga prioritetet e axhendës së tij do të ishte vendosja e masave të sigurisë në Aeroportin Ndërkombëtar.

Komiteti i Kartave

Komiteti u mbledh dy herë gjatë këtij viti dhe pati komunikime të shpeshta lidhur me raportet për Produktet e Kartave dhe incidentet e mashtrimeve. Anëtarët kërkuar një bashkëpunim më të gjerë përmes një projekti të veçantë për rritjen e ndërgjegjësimit për përdorimin e kartave të kreditit në vend dhe organizimin e një trajnimit të dytë nga VISA International

School për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në Tiranë.

Komiteti u përqendrua në mandatet dhe vendosjen e çmimeve sipas skemave të pagesave, të cilat kërkojnë zbatim teknik nga anëtarët dhe përpunuesit përkatës të palëve të treta. Përveç kësaj, bankat ngritën shqetësimet e tyre lidhur me përmbushjen e afateve kohore.

Komiteti i Përputhshmërisë

Pas këtij trajnimit dhe takimeve të vazhdueshme mes FIU dhe bankave tregtare, Komiteti dhe drejtorja e PPP-së organizuan një takim të përbashkët duke u përqendruar në çështje të tilla si: performanca e raportimit të rasteve të dyshimta nga sistemi bankar, mënyra e trajtimit të rasteve të mashtrimit, rastet e dyshuara të financimit të terrorizmit, përgatitja për vlerësimin e ardhshëm të Shqipërisë nga MONEYVAL, etj.

Në gusht, anëtarët e Komitetit u mbledhën për të diskutuar lidhur me iniciativën e Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit të Parave (GDAML) për kryerjen e disa ndryshimeve dhe shtesave në Ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”. Nën koordinimin

e Sekretariatit, bankat vijuan komunikimin me shkrim me këtë Autoritet me qëllim dërgimin e komenteve dhe propozimeve të tyre.

Gjatë 3 takimeve të organizuara gjatë vitit, ndër temat e tjera të diskutimit ishin edhe unifikimi i raporteve të bankave me atë të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (HIDAACI), zbatimi i Standardeve të Përbashkëta të Raportimit (CSR) dhe projekti për zhvillimin e një programi trajnimit (në gjuhën shqipe) për PPP dhe luftën kundër financimit të terrorizmit.

Komiteti emëroi Z. Ndue Maluta, përfaqësues i Bankës Kombëtare Tregtare, si kryetarin e ri.

Komiteti i Burimeve Njerëzore

Komiteti u mbledh 4 herë dhe trajtoi pjesën më të madhe të çështjeve të

programeve të trajnimit të menaxhuara dhe të zhvilluara nga AAB, si për shembull:

KOMITETE TEKNIKE

mundësitë e punësimit për personat me aftësi të kufizuara, "Hartëzimi i vendeve të punës" për Anketën e Pagave të kryer nga Grupi Hay, Raporti i KPI, etj.

Mbledhja e një grupi pune të ngritur nga Komiteti i Burimeve Njerëzore iu dedikua hartimit të formatit standard për "Vlerësimin e riskut në vendin e punës", i cili do të vendoset në dispozicion të çdo anëtarit dhe më pas do të konsiderohet si dokument bazë.

Një tjetër temë e këtij diskutimi ishte pjesëmarrja e bankave anëtare në Anketën e Pagave të Grupit Hay. Sekretariati i AAB-së ka koordinuar komunikimin e bankave anëtare me Grupin Hay, i fokusuar në organizimin e punës për shpërndarjen e të dhënave lidhur me raundin vjetor të Anketës Vjetore të Pagave për Bankat. Raporti iu dërgua bankave pjesëmarrëse gjatë gjysmës së dytë të vitit.

Gjatë këtyre takimeve u mbajtën dy prezantime nga Drejtuesi i Institutit Grek të Bankave, si në vijim: prezantimi i parë lidhur me programet e trajnimit të ofruara nga instituti dhe bashkëpunimi i mëtejshëm me AAB-në dhe prezantimi i dytë u fokusua në Standardin Triple E të Cilësisë të ofruar

nga EBTN për Triple E EFCB (Certifikata Evropiane për Bankat).

Gjatë këtyre trajnimeve, mes çështjeve më të rëndësishme të trajtuara nga anëtarët e Komitetit ishin edhe hartimi i programeve të certifikuara në gjuhën shqipe të menaxhuara nga AAB për pastrimin e parave, përputhshmërinë (me mbështetjen e ATTF ose të Institutit Grek të Bankave), kryerja e një "Vlerësimi për nevojat për trajnime", si dhe një program intensiv trajnimi për edukimin e punëkërkuësve të rinj në bashkëpunim me Partners Albania.

Sekretariati i AAB-së, me ndihmën e Komitetit të Burimeve Njerëzore, identifikoi trajnimet më të nevojshme teknike që konsiderohen si të përshtatshme për punonjësit e bankave në Shqipëri, të cilat mund të mbështeten financiarisht nga Qendra e Trajnimeve në Luksemburg. Gjatë këtij takimi (15 nëntor), u diskutua propozimi i AAB, duke dhënë argumentet e duhura lidhur me mënyrën se si kjo e fundit do të mund t'i përfshijë këto trajnime teknike në axhendën e saj. Gjithashtu, AAB propozoi organizimin e programeve të certifikuara në Shqipëri, duke u ofruar mundësi shumë pjesëmarrësve të përfitojnë nga ekspertiza e trajnerëve ndërkombëtarë.

Komiteti i Sigurisë së Informacionit

Ky Komitet u mblodh 3 herë gjatë këtij viti. Në fillim të vitit, ata shqyrtuan programin e punës për vitin 2016. Anëtarët diskutuan mbi domosdoshmërinë e trajnimeve në fushën e sigurisë së informacionit, të shoqëruara me dhënien e certifikatave përkatëse nga institucione ndërkombëtare të njohura, si dhe kanalet e mundshme të bashkëpunimit të krijuara me Shoqatën e Bankave në Kosovë. Gjithashtu, anëtarët e Komitetit shqyrtuan edhe ndërmarrjen e iniciativave të tjera gjatë vitit, si për shembull: informacione për rastet e mashtrimit/shkeljeve në sektorin bankar në Shqipëri, hartimi i informacionit

bazë për mbrojtjen dhe parandalimin nga ana e përdoruesve dhe realizimi i një videoje informative, prezantim për Sistemet e Inteligjencës së Sigurisë, takim i përbashkët me Komitetin e Kartave dhe Përputhshmërisë për çështje me interes të përbashkët.

Në Maj, Kryesia e Komitetit përfaqësoi AAB-në në tryezën e rumbullakët të organizuar nga Ministria e Inovacionit, ku u diskutua projektligji i ri për Sigurinë Kibernetike. Ky takim konsultativ kishte për qëllim nxitjen e iniciativës së re të qeverisë shqiptare në përputhje me iniciativën e Bashkimit Evropian për sigurinë e rrjeteve

dhe sistemeve që ofrojnë shërbime kritike për vendin.

Në tetor, Komiteti, në bashkëpunim me Sekretariatit e AAB-së, organizoi Forumin për Sigurinë e Bankave. Ky forum vjetor shërben si një platformë për shkëmbimin e ideve, përvojave dhe zhvillimeve të fundit në vend dhe jashtë vendit, si dhe dinamikat në fushën e sigurisë së informacionit bankar. Në këtë forum ishin të ftuar edhe ekspertë vendas. Disa nga temat e përfshira në agjendë ishin si më poshtë:

Siguria dixhitale, evolucioni i kërcënimeve, mbrojtja nga Ransomware, gatishmëria dhe mbrojtja nga incidentet në këtë mjedis kaq kërcënues, praktikat më të mira dhe kurthet që duhen shmangur. Përveç këtij eventit dhe në kuadër të muajit të rritjes së ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike, Sekretariati i AAB-së transmetoi tre video informative, të cilat ishin përfshirë në serinë "Banka ime", përkatësisht: "Mbroni postën tuaj elektronike", "Mbroni identitetin tuaj në internet" dhe "Mbroni celularin tuaj".

Komiteti i Auditorëve të Brendshëm

Gjatë 2 takimeve të organizuara gjatë vitit, pjesëmarrësit ngritën shqetësimet e tyre lidhur me përpjekjet që duhen ndërmarrë për perceptimin e duhur të funksioneve të auditimit të brendshëm. Anëtarët ngritën problematikat lidhur me rregulloren "Për sistemin e kontrollit të brendshëm në banka dhe degët e bankave të huaja", veçanërisht lidhur me kërkesat e raportimit vjetor në Bankën e Shqipërisë. Gjithashtu, Komiteti zhvilloi diskutime lidhur me listën e prioriteteve për trajnimet që do të organizohen këtë vit dhe mundësitë e tjera për bashkëpunim. Gjatë këtyre takimeve u theksua se auditorët e brendshëm duhet të jenë pjesë e veprimtarive të AAB-së, si

për shembull dhënia e kontributit të tyre përmes artikujve dhe botimeve në revistën "Bankieri" dhe mbajtja e leksioneve të hapura në universitete, si pjesë e axhendës së Edukimit Financiar të AAB-së.

Në Nëntor, në kuadër të bashkëpunimit të krijuar me Institutin Shqiptar të Auditimit të Brendshëm (AIIA), u organizua një takim mes Sekretariatit të AAB-së dhe përfaqësuesve të AIIA-s. Gjatë këtij takimi, pjesëmarrësit diskutuan lidhur me bashkëpunimin e AAB-së dhe AIIA-s për profesionin e auditimit të brendshëm në sektorin bankar si dhe për organizimin e trajnimeve dhe seminareve të përbashkëta.

Komiteti Ligjor

Komiteti u mbledh shtatë herë gjatë vitit 2016, kryesisht për të diskutuar mbi nevojën për ndryshime ligjore dhe çështje të tjera ligjore që lidhen me sektorin bankar. Gjatë këtij viti, Komiteti u përqendrua në: (i) ligjin "Për barrët siguruese", i ndryshuar, i cili shkaktoi shfuqizimin e disa përkufizimeve të rëndësishme në lidhje me kolateralin financiar. Nga ana tjetër, AAB në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë këmbënguli që ky ndryshim i fundit duhet të shfuqizohet, duke marrë në konsideratë pozicionin e vështirë të bankave në

trajtimin e kolateralit financiar. Ky ligj u ndryshua përfundimisht duke marrë në konsideratë problematikat e sektorit bankar, (ii) ndryshimet e nevojshme të kuadrit ligjor me qëllim ekzekutimin me sukses të kolateralit, duke u përfshirë thellësisht në ndryshimet e zbatuara të Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, dhe rekomandimet për projektligjin e ri "Për falimentimin", (iii) projektligjin "Për rikuperimin dhe rezolutat e bankave në Republikën e Shqipërisë".

Përveç kësaj, grupi i punës i krijuar nga ky Komitet zhvilloi tre takime me përfaqësuesit

KOMITETE TEKNIKE

e Bankës së Shqipërisë për të diskutuar mbi vërejtjet e unifikuara të sistemit bankar në lidhje me këtë projektligj dhe udhëzimet e reja të përbashkëta të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave "Për pagesën e shërbimit të përmbaruesit privat". Duke marrë parasysh ndryshimet në Kodin e

Procedurës Civile, Komiteti u mbledh disa herë për të diskutuar mbi çështjen kryesore lidhur me tarifën dhe mënyrën e pagesës, të cilat u dërguan më pas për shqyrtim në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave.

Komiteti i Marrëdhënive me Publikun –

Ky Komitet zhvilloi 4 takime gjatë vitit, ku anëtarët diskutuan kryesisht lidhur me veprimtaritë e zhvilluara dhe të koordinuara nga Sekretariati për marrëdhëniet me mediat, edukimin financiar dhe veprimtaritë për përgjegjësitë sociale të ndërmarra nga bankat. Ky Komitet ishte mbështetësi kryesor i veprimtarive të organizuara nga AAB gjatë Javës së Parasë.

Raporti vjetor CSR i AAB-së i hartuar për herë të parë në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm ishte një tjetër temë e gjerë diskutimi. Në këtë drejtim, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së organizoi një takim me Këshilltarin për Mjedisin dhe Personin e Kontaktit për OZHQ-të në Zyrën e Koordinatorit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Gjatë këtij takimi u theksua bashkëpunimi

mes sektorit bankar dhe OKB-së, me synim hartimin e një sërë objektivash të zhvillimit të qëndrueshëm për shqyrtimin dhe ndërmarrjen e masave të duhura të pritshme nga anëtarët e AAB-së.

Me kërkesë të Sekretariatit, anëtarët dhanë kontributin e tyre për skenarët e videove informative, të xhiruara në kuadër të veprimtarive të Edukimit Financiar të ndërmarra nga AAB.

Gjatë këtij viti, zgjedhjet për kryesinë e Komitetit u mbajtën dy herë. Në fund të vitit, në krye të këtij Komiteti ishte Zj. Viola Smaja nga Raiffeisen Bank Albania, e cila u emërua në pozicionin e kryetares së re, ndërsa Zëvendës Kryetare u emëruan Zj. Lutjana Konomi nga Tirana Bank dhe Zj. Lauresha Basha nga Credins Bank.

Komiteti i Sistemeve të Pagesave

Ky Komitet zhvilloi 8 takime të rregullta dhe 3 takime të tjera të grupeve të punës të krijuara për ndjekjen e tre projekteve të iniciuara nga Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave (NPSC), përkatësisht: projekti për urdhër-pagesat e standardizuara, projekti për përmirësimin/zbatimin e Skemës së Debitimit Direkt dhe projekti "Klerimi dhe shlyerja e pagesave në euro brenda vendit".

Në kuadër të projektit të urdhër-pagesave të standardizuara, formulimi i Urdhër-pagesave të Standardizuara u hartua nga grupi i punës i krijuar brenda këtij Komitetit, bazuar në komentet e dërguara

nga secila bankë anëtare. Në këtë formular, i cila do të përdoret për transfertat brenda dhe jashtë vendit, janë përfshirë pjesa më e madhe e të dhënave teknike të sugjeruara nga bankat, të cilat u përfshinë më pas në draftin përfundimtar. Pas kësaj, bankat miratuan paraprakisht formularin teknik dhe, në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet tyre, ky formular u miratua nga të gjitha bankat anëtare. Në mbështetje të përdorimit dhe miratimit të këtij formulari, së bashku me formatin përfundimtar u hartua dhe u shpërnda edhe një manual për përdorimin e kësaj urdhër-pagese. Më 24 maj, formati në fjalë, i cili kaloi në

fazën e parë të unifikimit, u prezantua përpara Komitetit Kombëtar të Sistemeve të Pagesave. Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar më 14 dhjetor, bankat anëtare të AAB-së miratuan formatin e unifikuar të urdhër-pagesës.

Lidhur me aktivizimin e Skemës së Debitimit Direkt Ndërbankar, Banka e Shqipërisë prezantoi fluksin e punës së procesit duke përfshirë nevojat për zhvillimin e sistemit dhe testet që duhet të kryhen nga bankat në bashkëpunim me shërbimet publike dhe bankën qendrore. Për këtë qëllim, janë organizuar takime të ndryshme në nivel teknik, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike, Bankës së Shqipërisë, departamenteve të sistemeve të pagesave të bankave dhe departamenteve të IT-së dhe shoqërive të shërbimeve publike (OSHEE, UK Tirana, Albtelekom) për të diskutuar më tej mbi marrëveshjen e bashkëpunimit mes palëve të lidhura për ekzekutimin e debitimit direkt ndërbankar dhe formalizimin e këtij procesi.

Anëtarët e Komitetit dhanë kontributin e tyre në pyetësin e hartuar nga Banka e Shqipërisë, i cili do të shërbejë si një studim fizibiliteti i kryer për vlerësimin e kostos së transaksioneve të pagesave në EUR brenda territorit shqiptar. Ky projekt përbën në

mënyrë të konsiderueshme një vlerë të shtuar si për tregun ashtu edhe për bankat. Ky projekt do të shërbejë gjithashtu si një studim kërkimor për shërbimet e ofruara nga bankat përkatëse në nivel institucional krahasuar me tregun, dhe do të gjenerojë të dhëna për kostot e shfrytëzimit të parasë.

Në prill të vitit 2016, u zhvilluan zgjedhjet për Kryetarin e Komitetit dhe Zj. Najada Xhaxha nga Tirana Bank u rizgjodh si kryetare e re, ndërsa Zj. Marseda Dumani nga BKT dhe Z. Almir Zeneli nga Raiffesien Bank u zgjodhën si Zëvendëskryetarë.

Në lidhje me prezantimin e platformës për shlyerjen dhe klerimin e pagesave nga celulari, në gusht të vitit 2016, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, Kryetarja e Komitetit të Sistemit të Pagesave të AAB-së dhe përfaqësues të tjerë të Departamentit të Pagesave të Bankës së Shqipërisë zhvilluan një takim me përfaqësuesit e Shoqërisë ProgressSoft. Ky takim u përqendrua në ecurinë e tre projekteve në vijim, përkatësisht: klerimi i pagesave në euro brenda vendit, përmirësimi/zbatimi i Skemës së Debitimit Direkt Ndërbankar dhe klerimi i pagesave nga celulari, si dhe krijimi i një shoqërie nga industria bankare për menaxhimin e projekteve të mësipërme.

Komiteti i Thesarit dhe Tregut Financiar

Ky Komitet organizoi 3 mbledhje të rregullta gjatë vitit, të cilat u përqendruan në Marrëveshjen Master për Transaksionet e Derivateve Financiare. Sekretariati i AAB-së koordinoi punën e grupit të punës së ngritur për hartimin e përmbajtjes fillestare të Marrëveshjes Master, e cila më pas u miratua nga të gjitha bankat anëtare.

Më pas, kjo marrëveshje u rishikua nga Komiteti Ligjor i AAB-së për të garantuar përputhshmërinë me legjislacionin

shqiptar, në mënyrë që të shërbejë si bazë për ndërtimin e marrëdhënieve dypalëshe mes bankave anëtare.

Sekretariati i AAB-së, në bashkëpunim me Thomson Reuter, organizoi disa trajnime për certifikimin e produktit të Thomson Reuter në desktopin EIKON.

TAKIME TË TJERA

AAB - Strukturat Shtetërore

Në shkurt të vitit 2016, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së zhvilluan një takim me Zëvendësministrin e Punëve të Brendshme për të diskutuar lidhur me **sigurinë e transportit të vlerave monetare të bankave**. Në vijim të pikave të diskutimit të përfshira në agjendë, Z. Canacaris ngri problematikën e automjeteve të blinduara të përdorura nga Shoqëritë Private të Sigurisë për transportin e parave, të cilat nuk i përmbushin kriteret dhe as standardet minimale për përmbushjen e kësaj detyre, si dhe çështje të tjera shqetësuese lidhur me këtë problematikë. Për rrjedhojë, kjo problematikë u diskutua më hollësisht në takimet teknike të zhvilluara me Policinë e Shtetit.

Më 30 gusht, Sekretariati i AAB-së në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë organizoi një takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me nevojat për përmirësimin e masave të sigurisë. Takimi u zhvillua në ambientet e Ministrisë me pjesëmarrjen e Z. Stefan Çipa, Zëvendësministër i Punëve të Brendshme, përfaqësuesve nga Kabineti i Ministrit, Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Mbrojtjes së Kufijve dhe Migracionit, Zj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore, Z. Christian Canacaris, Kryetar i AAB-së dhe Z. Spiro Brumbull, Sekretar i Përgjithshëm i AAB-së. Pjesëmarrësit diskutuan mbi masat që duhen marrë për përmirësimin e sigurisë në ambientet e bankave dhe për sigurinë e vlerave monetare të bankave gjatë transportit.

Më 9 maj, anëtarët e Komitetit të Përputhshmërisë dhe Sigurisë së IT-së, së bashku me përfaqësuesit e Sekretariatit të AAB-së, morën pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Drejtësisë në kuadër të vizitës së misionit të ekspertëve të Këshillit të Evropës për **Projektin e Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Për identifikimin e të ardhurave nga krimet**

në internet në Evropën Juglindore dhe në Turqi" (iPROCEEDS). Qëllimi i këtij takimi të zhvilluar me pjesëmarrjen e këtyre aktorëve vendas ishte mbledhja e informacionit dhe hartimi i një raporti të përgjithshëm mbi situatën. Gjatë këtij takimi ishin të pranishëm përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, AML-së, Ministrisë së Drejtësisë dhe Policisë së Shtetit.

Më 7 shtator, Sekretari i Përgjithshëm dhe dy përfaqësues të Kryesisë së Komitetit Ligjor të AAB-së përfaqësuan AAB-në në seancën dëgjimore të Komisionit Ligjor Parlamentar, duke diskutuar mbi paketën ligjore për reduktimin e kredive me probleme (pesë projektligje). Përfaqësuesit e AAB-së u përqendruan kryesisht në projekt-ndryshimet në ligjin për përmbaruesit privat dhe shtetëror (lidhur me tarifën e kompensimit), si dhe ndryshimet e propozuara në Kodin e Procedurës Civile (neni 511) dhe në Kodin Civil. Më 17 nëntor, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së u takuan me Zëvendësministrin e Financave për të diskutuar mbi kontributin e bankave për përputhshmërinë me projektligjin "Për rezolutat e bankave" dhe ligjin "Për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave", i cili duhet të parashikohet gjithashtu në legjislacionin tatimor si shpenzim i zbritshëm bankar që nuk rimburohet për qëllime tatimore. Pas këtij takimi, Sekretariati i AAB-së i dërgoi një letër Komisionit Parlamentar të Ekonomisë ku trajtohej kjo çështje, me qëllim përfshirjen e kësaj dispozite në projekt-ndryshimet e Ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", i cili në atë kohë po diskutohej me Komisionin.

Më 21 dhjetor, përfaqësuesit e bankave zhvilluan një takim me Z. Eduart Shalsi, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Vepërimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin për të diskutuar mbi ndikimin e projekt ligjit të ri "Për energjinë e rinovueshme" te shoqëritë që operojnë në sektorin e energjisë hidroelektrike

(HEC-et), kryesisht te shoqëritë e vogla të financuara nga sektori bankar.

Në kuadër të Projektit të Binjakëzimit të BE-së **“Përmirësimi i Sistemit të Përmbarrimit në Shqipëri”**, me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, më 22 dhe 26 shtator, Sekretariati i AAB-së organizoi dy takime me pjesëmarrjen e ekipit të binjakëzimit. Një nga masat e rekomanduara ishte ngritja e Qendrës së Ankandëve Publike, e cila do të mundësonte menaxhimin dhe shitjen e pronave të konfiskuara të vendosura në dispozicion nga Shërbimet e Përmbarrimit Publik dhe Privat. Qëllimi i këtij projekti është thjeshtëzimi i procedurës së përmbarrimit, reduktimi i afatit të procedurës së përmbarrimit, reduktimi i ngarkesës së punës në gjykata dhe ulja e fluksit të rasteve të përmbarrimit në gjykata. Gjithashtu, kjo pritet të përmirësojë performancën dhe

profesionalizmin brenda organeve të përmbarrimit, përmes zbatimit të ligjit të ri “Për procedurat përmbarrimore”.

Pas takimit me Sekretariatit e AAB-së, ekipi i binjakëzimit vijoi me takimet e tjera të planifikuara me përfaqësues të bankave të veçanta në Shqipëri, për të pasur një panoramë të qartë të çështjeve më të rëndësishme teknike dhe të problematikave të sistemit bankar në lidhje me procedurat përmbarrimore.

Më 21 dhe 22 tetor, dy përfaqësues të Kryesisë së Komitetit Ligjor të AAB-së dhe përfaqësues të Sekretariatit morën pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar me Ministrinë e Drejtësisë nga **Projekti i Binjakëzimit të BE-së “Ndërgjegjësimi mbi çështjet e përmbarrimit”**. Në këtë tryezë të rrumbullakët morën pjesë gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, përmbarrues dhe aktorë të tjerë të lidhur me to.

AAB - Banka e Shqipërisë

Gjatë vitit 2016, përfaqësuesit e bankave (anëtarët e komitetit ose grupet e posaçme) zhvilluan disa takime të ndryshme me përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë për trajtimin e problemeve të identifikuar, ose me fokus në rregulloret përkatëse në proces rishikimi.

Në kuadër të projekteve të ndërmarra nga Komiteti Kombëtar i Sistemeve të Pagesave, gjatë këtij viti u organizuan disa takime. Këto takime i orientuan pjesëmarrësit drejt përmbushjes së objektivave të këtij takimi dhe u erdhën në ndihmë për të kuptuar më qartë se çfarë pritet prej tyre për të mbështetur më së miri këtë projekt..

Në Mars të vitit 2016, Sekretariati i AAB-së organizoi një takim me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bankave, BSH-së, Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe shoqërinë ALEAT, për të diskutuar mbi qëndrimin e fundit të Bankës së Shqipërisë lidhur me vlefshmërinë e nënshkrimit elektronik në kontratat bankare, në përputhje me rregulloret në fuqi.

Ndër temat e tjera që u diskutuan gjatë takimeve të përbashkëta mund të rendisim rregulloren e rishikuar “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, “Marrëdhëniet Biznes-Bankë: Perspektiva e huadhënies 2016”, etj.

Në Mars të vitit 2016, gjatë takimit mes Bankave dhe Bizneseve të organizuar me nismën dhe nën mbikëqyrjen e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, me pjesëmarrjen e drejtuesve të bankave tregtare dhe përfaqësuesve të shoqatave të biznesit, Z. Christian Canacaris, Kryetar i Shoqatës Shqiptare e Bankave, theksoi pritshmëritë e tij optimiste për veprimtarinë ekonomike në vitin 2016. Nga njëra anë, ky takim kishte si objektiv nxitjen e dialogut dhe mirëkuptimit mes sistemeve bankare dhe, nga ana tjetër, me komunitetin e biznesit, me të vetmin qëllim rritjen e numrit dhe vlerës së kredive për ekonominë, duke përshpejtuar kështu veprimtarinë ekonomike.

Pas disa komunikimeve dhe takimeve mes kryetarëve të AAB-së dhe Dhomës Kombëtare të Përmbarrimit (NCHB),

TAKIME TË TJERA

në janar 2016, përfaqësuesit e këtyre dy instituteve zhvilluan një takim me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të BSH-së. Gama e gjerë e temave të diskutuara: identifikimi i problematikave të fundit mes NCHB dhe AAB, zhvillimi i negociatave

dhe diskutimeve që synojnë ofrimin e zgjidhjeve praktike, diskutime lidhur me ndryshimin e pagesës së tarifave të përmbarimit, problematikat e ngritura në ekzekutimin e urdhrave të përmbarimit në llogaritë bankare të klientit, etj..

AAB - Komisioni Evropian dhe institucionet e tij

Në kuadër të hartimit të Raportit Vjetor 2016 për Shqipërinë dhe, më konkretisht, zhvillimet e kriterëve ekonomike, Delegacioni i BE-së zhvilloi disa takime konsultative me Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së, përkatësisht në Prill, Shtator dhe Tetor.

Më 6 dhjetor, në kuadër të Programit të Reformës Ekonomike për Shqipërinë, Zj. Ana Vukosavlevic nga DG për Punësimin, Çështjet dhe Përfshirjen Sociale vizitoi

Shqipërinë dhe zhvilloi një takim me AAB-në për të diskutuar mbi çështjet që lidhen me kontributin e sektorit bankar në përmirësimin e përfshirjes financiare.

Më 21 nëntor, gjatë takimit të zhvilluar me Sekretarin e Përgjithshëm, përfaqësuesit e Finance in Motion (FiM) prezantuan fondet dhe pasqyruan shkurtimisht veprimtaritë dhe zhvillimet në Shqipëri në lidhje me sektorin bankar dhe edukimin financiar.

AAB - Banka Botërore

Sekretariati i AAB-së mirëpriti përfaqësuesit e Bankës Botërore në kuadër të dy projekteve, përkatësisht: për përfshirjen financiare dhe për pagesat, të miratuara nga Komiteti Kombëtar i Pagesave. Ekipi gjithashtu u takua edhe me përfaqësuesit e dy bankave anëtare, të cilët diskutuan lidhur me pagesat dhe shërbimet elektronike që aktualisht ofrojnë bankat, me fokus të veçantë në lehtësimin e pagesave, krijimin e partneriteteve të mundshme mes shoqërive që ofrojnë shërbime të transferimit të parave (Money Gram, Western Union), kërkesat minimale për hapjen e një llogarie në emër të klientëve individë/biznes, etj.

Gjatë vitit 2016, Z. Brumbulli u takua me përfaqësuesit e Bankës Botërore, duke vendosur një fokus të veçantë në çështjen e kredive me probleme (NPL) dhe ristrukturimin e borxhit, si dhe procedurat dhe tarifën e përmbaruesve privat.

Kryetari i AAB-së dhe Sekretari i Përgjithshëm

i AAB-së organizuan një takim përcjelljeje me specialistin e Bankës Botërore të sektorit financiar për Evropën dhe Azinë Qendrore, Z. Mike Edwards, si pjesë e angazhimeve të fundit të mandatit të Z. Edwards në Shqipëri. Ky takim përfaqësoi një mundësi shumë të mirë për të vënë në dukje kontributin e ofruar dhe për të diskutuar mbi të ardhmen e këtij sektori.

Në kuadër të vizitës në Shqipëri të Zj. Alexandra Kestic, Zyrtare e lartë e IFC-së për Investimet, më 23 nëntor u organizua një takim mes përfaqësuesve të IFC-së dhe Sekretariatit të AAB-së. Në këtë kontekst, u kërkuar më shumë informacion në kuadër të diskutimeve lidhur me zhvillimet më të fundit në sektorin financiar dhe më konkretisht në sektorin bankar, zhvillimet më të fundit në kuadrin rregullator, perspektivat e ardhshme dhe vlerësimin e rolit të mundshëm të IFC-së në këtë drejtim.

AAB - Agjencia për Transferimin e Teknologjisë Financiare (ATTF)

Më 19 prill, Z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i AAB-së, mirëpriti Z. Ben Lyon, Menaxher për Zhvillimin e Biznesit në Agjencinë e Transferimit të Teknologjisë Financiare në Luksemburg (ATTF) në një takim të veçantë në ambientet e AAB-së. Qëllimi i vizitës së Z. Lyon ishte të kuptonte më mirë nevojat e Shqipërisë dhe të gjente mënyrën se si ATTF mund t'i shërbente në mënyrë më efektive këtyre nevojave.

Për më tepër, Z. Lyon zhvilloi disa takime të tjera në Shqipëri me përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë.

ATTF tashmë gëzon një bashkëpunim shumë konstruktiv me Shoqatën Shqiptare të Bankave në Tiranë, ku ajo zhvillon seminare për transferimin e njohurive teknike në sektorin financiar shqiptar.

AAB - Shoqata Evropiane e Trajnimeve Bankare & Shërbime Financiare (EBTN) –

AAB, në cilësinë e anëtares së asociuar, mori pjesë në dy veprimtari të EBTN-së gjatë vitit 2016.

Më 22 janar u organizua takimi i anëtarëve të EBTN. Ky event u programua në bashkëpunim me anëtarin italian të EBTN-së, ABIFORMAZIONE - departamenti i trajnimeve të Shoqatës së Bankave Italiane - e cila e organizoi takimin në ambientet e zyrave të tyre në Romë të Italisë. Në këtë takim morën pjesë 30 drejtues që përfaqësonin 24 organe anëtare të EBTN-së, të cilët u përqendruan në akreditimin Triple E, një iniciativë e EBTN-së që i mundëson çdo organizatë që ofron kualifikime profesionale në shërbimet

financiare të aplikojë për njohjen cilësore të emërtimeve të tyre sipas standardit Triple E të EBTN-së.

Më 6 tetor u organizua konferenca e EBTN-së, me fokus në aftësitë dhe kompetencat e ardhshme të punonjësve të bankave. EBTN, zëri i bashkuar i ofruesve të trajnimeve dhe kualifikimeve profesionale në industrinë e shërbimeve bankare dhe financiare, u takua me palët e interesit në Bruksel për të diskutuar lidhur me parashikimet për aftësitë dhe kompetencat e ardhshme të punonjësve të bankave.



EVENTE

Eventet janë instrumenti thelbësor i strategjisë dhe komunikimit për AAB-në, të cilat shërbejnë për takimin e profesionistëve të industrisë bankare në vend dhe në rajon. Këto veprimtari janë një mundësi shumë e mirë për të promovuar zhvillimet që ndodhin në sistemin bankar dhe për të marrë informacione mbi ecurinë e vendeve të tjera.

Në këtë seksion pasqyrohen eventet e ndryshme të organizuara nga AAB gjatë vitit.

Ndryshimet në Kodin e Punës

Takimi u organizua më 6 prill nga AAB në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Inspektoratin e Punës. Pjesëmarrësit diskutuan lidhur me problematikat e ngritura nga bankat dhe aktet specifike që kanë nevojë për interpretim. Në këtë event morën pjesë Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, Drejtori i Inspektimit, Marrëdhënies të Punës dhe Dialogut Social pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale, si dhe përfaqësues të tjerë të autoriteteve përkatëse.



Takimi i 42-të i anëtarëve të EBF-së

Më 29 prill 2016 në Tiranë, AAB organizoi për herë të dytë takimin e bashkëpunëtorëve të Federatës Evropiane të Bankave (EBF). Ky takim vjetor mbledhi së bashku menaxherë të nivelit të lartë të shoqatave kombëtare të bankave, si nga vendet evropiane në zhvillim ashtu edhe nga vendet anëtare të BE-së. Gjatë këtij takimi mbajtën fjalën e tyre të ftuar të nivelit të lartë si Z. Erion LUCI, Zëvendësministër i Financave, Zj. Natasha AHMETAJ, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë dhe Z. Christian CANACARIS, Kryetar i AAB-së.



Konferencë për "Bankingu digjital në Shqipëri"

Më 25 maj, AAB në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave, organizoi konferencën e parë kombëtare të titulluar "Bankingu digjital në Shqipëri". Kjo konferencë kishte si objektiv nxitjen e teknologjive të reja të përdorura nga sektori bankar me qëllim ofrimin e shërbimeve dhe produkteve për qytetarët shqiptarë. Ndër temat e tjera



aktuale të trajtuara gjatë tre sesioneve të konferencës ishin: shërbimet novatore të pagesave, zhvillimet më të fundit në lidhje me transformimin digjital dhe rolin e tij në industrinë bankare, sfidat për të ardhmen, kuadri rregullator në Bashkimin Evropian dhe ndikimi i tij në Shqipëri dhe situata aktuale në tregun e brendshëm. Në këtë event morën pjesë mbi 160 pjesëmarrës nga sektori bankar dhe institucione financiare publike dhe private.



Promovimi i "Raporti CSR 2015 - Bankat për Shoqërinë"

Më 13 korrik, ABB organizoi një ceremoni për promovimin e Raportit CSR 2015 - Bankat për Shoqërinë. Pjesëmarrësit u mirëpritën nga Zj. Milva Ekonomi, Ministre e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Zj. Natasha Ahmetaj, Zëvendësguvernatore e Bankës së Shqipërisë, Z. Bas Berends, përfaqësues i UNDP-së, Zj. Brunilda Paskali, Zëvendës Kryetare e Bashkisë dhe Zj. Emanuela Zaimi, Drejtore Ekzekutive/ Themeluese e Fondacionit të Sindromës "Down" në Shqipëri.



Mbledhja vjetore e SWIFT UGM

Më 8 shtator, AAB organizoi në ambientet e saj takimin vjetor të SWIFT UGM, me pjesëmarrjen e SWIFT Austria dhe CIS. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të departamenteve të pagesave dhe departamenteve të përputhshmërisë të bankave anëtare. Në këtë axhendë u përfshinë tema të tilla si: sistemet/siguria e aplikacioneve, nismat e reja në sektorin e pagesave, "Përmirësimi" i sistemit SWIFT, Release 7.2.0.0 si dhe aplikimi i një tarife vjetore për aplikacionin e ri të quajtur SWIFT Smart, i cili do të ofrojë të mësuarit në distancë, regjistrin e KYC, etj.



Forumi i 5-të i Sigurisë Fizike të Bankave

AAB, me mbështetjen e Komitetit të Sigurisë së Bankave, organizoi Forumin e 5-të të Sigurisë Fizike në Bankë, i cili u zhvillua më 21 shtator. Në këtë forum morën pjesë përfaqësues të bankave tregtare që operojnë në Shqipëri dhe në Kosovë, përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Shoqata e Bankave të Kosovës, Shoqëri të Mbrojtjes së Sigurisë



EVENTE

Fizike dhe TIA. Agjenda e këtij forumi theksoi rëndësinë e organizimit të strukturave të sigurisë, kuadrit ligjor, ngjarjeve të fundit që ndodhën në sektorit bankar në lidhje me çështjen e grabitjes së parave dhe gjithashtu shprehu domosdoshmërinë e organizimit të takimeve të tilla në të ardhmen. Ky event u mbulua gjerësisht nga mediat.



Forumi i Sigurisë së Informacionit

Më 13 tetor, AAB, me mbështetjen e Komitetit të Sigurisë së Informacionit, organizoi Forumin e Sigurisë së Informacionit. Pjesëmarrësit në këtë event ishin ekspertë të bankave shqiptare dhe ndërkombëtare, përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (NAIS), Bankës së Shqipërisë, Shoqatës së Bankave të Kosovës, shoqëri konsulence, etj. Ky forum u organizua në përputhje me fushatën e ritjes së ndërgjegjësimit të lançuar nga vendet anëtare të BE-së, e cila promovon sigurinë kibernetike mes qytetarëve dhe avokatëve për ndryshimet në perceptimin e kërcënimeve kibernetike, duke promovuar sigurinë e të dhënave dhe të informacionit, edukimin, shkëmbim e praktikave të mira dhe konkurse, etj.



PROJEKTE

- Urdhër-pagesat e standardizuara
- Skema e Debitimit Direkt Ndërbankar
- Klerimi dhe shlyerja e pagesave në euro brenda vendit
- Standardet KPI HR 2016
- Bashkëpunimi me 10 Partnerë Ndërkombëtar të Trajnimit, duke përfshirë: IFC, Qendra e Trajnimeve, Instituti për Trajnimet për Bankat (IFBL), Instituti Grek i Bankave (HBI) dhe ATTF Luksemburg për përgatitjen e kualifikimeve brenda vendit.

AKTIVITETE SOCIALE

Aktivitetet me përfaqësuesit e mediave

Më 14 janar, me rastin e fillimit të Vitit të Ri, AAB organizoi një takim me gazetarë ekonomikë të mediave të shkruara dhe elektronike, analistë dhe drejtues të mediave në Shqipëri. Kryetari i AAB-së mirëpriti të ftuarit dhe i informoi ata mbi gjendjen e përgjithshme të sistemit bankar në fund të vitit 2015, si dhe planet e ardhshme të Shoqatës për vitin në vijim.

Në 21-22 tetor, në Mal të Zi, AAB organizoi një udhëtim edukativ për 23 gazetarë të mediave të shkruara, elektronike dhe televizive. Ky program trajnimi u drejtua nga ekspertë të bankave. Pjesëmarrësit mësuan rreth disa aspekteve specifike të raportimit financiar, sistemit bankar dhe marrëdhënive me mediat, rrezikun e kredisë dhe kreditë me probleme, bankingun në internet, dixhitalizimin, sigurinë dhe transportin e vlerave monetare. Vizita e organizuar në Shoqatën e Bankave Malazeze ishte një pjesë shumë e rëndësishme e kësaj axhende.



Pritjet

AAB organizoi një festë përcjelljeje në nder të Zj. Endrita Xhaferaj, e cila u largua nga Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së.



Darka e Fund Vitit

Më 14 dhjetor, AAB organizoi darkën e fundit të vitit ku morën pjesë drejtorë dhe përfaqësues të bankave anëtare, të ftuar të veçantë nga BSH, si p.sh. Guvernatori, Zëvendës Guvernatori, Drejtori i Departamenteve Mbikëqyrëse dhe Shefi i Kabinetit, Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe anëtarët e Bordit Botues të revistës "Bankieri".



BANKAT ANËTARE / FAKTE DHE SHIFRA

Banka	Struktura e Aksionarëve	Vendi i origjinës	Aktivet (€000)	Kreditë (€000)	Investime Letra me Vlerë të Qeverisë (€000)
 ALPHA BANK	Alpha Bank A.E. 100%	Greqi	545,766	240,802	109,387
 abi AMERICAN BANK OF INVESTMENTS	Tranzit Sh.p.k 100%	Shqipëri	272,958	68,694	132,068
 BKT	Calik Finansal Hizmetler A.S. 100%	Turqi	2,861,046	954,487	1,114,246
 CREDINS bank <i>Ne flasin gjahën tuaj</i>	Individë dhe ASC Union 49.83%	Shqipëri	1,223,799	698,213	157,425
	B.F.S.E Holding BV 15.12 %	Holandë			
	Të tjerë 35.05%	Shqipëri			
 CBA	Kharafi Group 100%	Kuvajt	21,141	2,299	696
 Fibank First Investment Bank	Fibank AD 100%	Bullgari	138,987	52,129	54,679
 INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK rëndësi kanë vlerat	ICB Financial Group Holding (100%)	Zvicër	73,712	30,590	26,228
 INTESA SANPAOLO	Intesa Sanpaolo S.p.A. (100%)	Itali	1,105,735	334,541	406,950
 NATIONAL BANK OF GREECE	National Bank of Greece S.A. (100%)	Greqi	308,465	215,867	38,406
 ProCredit Bank	ProCredit Holding AG & Co. KGaA 100%	Gjermani	245,832	147,111	21,224
 Raiffeisen BANK	Raiffeisen SEE Region Holding GmbH - 100%	Austri	1,996,859	670,425	510,743
 SOCIETE GENERALE ALBANIA	SOCIETE GENERALE 88.64%	Francë	600,621	336,092	145,103
	Minority Shareholders 11.36%	Shqipëri			
 TIRANA BANK	PIREAU BANK 98.83%	Greqi	601,677	186,894	158,601
	TZIVELIS IOANNIS 1.17%				
 UNIONBANK	Unioni Financiar Tirane (UFT) Sh.p.k. 86.34%	Shqipëri	307,736	124,630	111,622
	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (10.12%)	UK			
	Individë (3.54%)	Shqipëri			
 UBA	Islamic Development Bank 86.70%	Arabia Saudite	55,695	24,593	-
	Ithmaar Bank 4.63%	Bahrain			
	Dallah Albaraka Holding Co. 2.32%	Bahrain			
	Business Focus SDN BHD 1.47%	Malajzi			
	Saudi Brother Commercial Co. 0.58%	Arabia Saudite			
	Individë 4.31%	Arabia Saudite			
 VENETO BANKA GRUPPO VENETO BANCA	Veneto Banca Italy 100%	Itali	195,440	81,010	3,039

	Kapitalet e veta (€000)	Depozita (€000)	Fitimi neto (€000)	Nr. degësh	Nr. punonjësish	Nr. ATM	Nr. karta të lëshuara	Karta Debiti	Karta Krediti	Nr. POS	E-banking	Mobile Banking	E-commerce
	76,215	435,093	(10,331)	35	416	50	85,205	76,618	8,587	1,283	PO	PO	JO
	29,702	232,635	3,054	19	243	33	13,821	13,156	665	N/A	PO	JO	JO
	331,428	2,225,593	55,391	92	1,311	151	333,048	281,563	51,485	4,305	PO	PO	PO
	99,553	1,063,501	1,959	57	800	64	70,315	66,391	3,924	514	PO	PO	PO
	9,748	9,620	(279)	2	28	-	-	-	-	N/A	PO	JO	JO
	17,038	119,007	2,685	10	140	30	30,848	27,146	3,702	-	PO	JO	JO
	10,715	55,715	(379)	6	93	6	966	966	-	-	PO	PO	JO
	144,232	931,555	16,626	32	575	49	88,472	88,472	N/A	543	PO	PO	JO
	60,857	228,501	196	26	309	35	19,855	19,403	452	-	JO	JO	JO
	35,766	201,894	65	18	258	73	40,823	40,220	603	267	PO	JO	JO
	185,893	1,695,916	(32,912)	79	1,363	174	223,260	200,796	22,464	1,370	PO	PO	PO
	65,662	474,745	2,234	37	410	61	44,408	44,282	126	-	PO	PO	JO
	107,486	470,202	(3,848)	39	432	71	64,587	60,504	4,083	189	PO	PO	JO
	27,311	252,118	1,509	30	362	40	31,301	28,285	3,016	-	PO	PO	JO
	11,312	44,155	230	6	77	-	-	-	-	-	JO	JO	JO
	25,088	167,039	(27,669)	15	132	16	10,800	10,400	400	135	PO	JO	JO

PASQYRAT FINANCIARE TË AAB-SË

PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

Përmbajtja:

- Pasqyrat e pozicionit financiar
- Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
- Pasqyra e fluksit monetar
- Shënime mbi Pasqyrat Financiare

Pasqyrat e pozicionit financiar

	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<u>AKTIVET</u>			
Aktive afatshkurtra			
Arka dhe Banka	4	14,755,093	9,325,817
Shpenzime të parapaguara	5, 6, 7	1,713,732	1,246,430
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		16,468,825	10,572,247
Aktivet Afatgjata			
Aktivet e qëndrueshme, neto	8	914,482	723,870
Totali i Aktiveve Afatgjata		914,482	723,870
TOTALI I AKTIVEVE		17,383,307	11,296,117
<u>DETYRIMET</u>			
Llogari të pagueshme	9	1,305,556	934,462
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		1,305,556	934,462
Aktivet Neto	10	16,077,751	10,361,655
TOTALI I DETYRIMEVE		17,383,307	11,296,117

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

AAB - FINANCIAL STATEMENTS

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<u>TË ARDHURAT</u>	11		
Kuotat e anëtarësisë		36,984,000	33,000,000
Të ardhura për trajnime		3,717,480	4,032,055
Interesat nga llogaritë rrjedhëse		-	7,885
Totali i të Ardhurave		40,701,480	37,039,940
<u>SHPENZIMET</u>			
Amortizimi	6	(163,119)	(170,238)
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme	6	(17,582)	(10,851)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrimit	12, 13, 16	(31,629,506)	(29,506,273)
Shpenzime për trajnime	12	(3,175,176)	(4,020,423)
Pagesa për Donacione	15	-	(8,758,141)
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit		-	(33,367)
Totali i Shpenzimeve		(34,985,383)	(42,499,293)
Teprica /Deficit i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		5,716,097	(5,459,353)
Aktivet Neto në fillim të vitit		10,361,654	15,821,008
Aktivet Neto në fund të vitit		16,077,751	10,361,655

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e fluksit monetar

	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Fluksi i parave nga veprimtaria e shfrytëzimit			
Teprica/Deficiti i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		5,716,097	(5,459,353)
Rregullime për:			
Amortizim	8	163,119	170,238
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme	8	17,582	10,851
Të ardhura nga interesa bankare (llogari rrjedhëse)		-	(7,884)
Pagesa për shpenzimet e parapaguara	7	459,520	(180,740)
Llogari të arkëtueshme		(926,822)	-
Pagesa për llogaritë e pagueshme	9	371,093	307,817
Interesat nga llogaritë rrjedhëse		-	7,884
Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit		5,800,588	(5,151,187)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	8	(371,312)	(94,265)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		(371,312)	(94,265)
RRITJA NETO E MJETEVE MONETARE		5,429,276	(5,245,452)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	4	9,325,816	14,571,268
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	4	14,755,093	9,325,816

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) janë përpiluar në datë 29.03.2017 dhe nënshkruar nga:



Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave



Albana HALLVAXHIU

Drejtoreshë e Departamentit të Financës

Banka Societe Generale Shqiptari

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Shënime mbi Pasqyrat Financiare për përfundimin e vitit në 31 Dhjetor 2016

1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar më 15 Prill 1999 me seli në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 9, Ap.3, Tiranë, Shqipëri.

AAB është një shoqatë jo fitimprurëse, e cila përpiket të promovojë standardet më të fundit Bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga 16 anëtarë, mbi baza vullnetare: Alpha Bank Shqipëri, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Societe General Albania, Banka Credins, Banka e Kreditit të Shqipërisë, FIBank Albania, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka Intesa SanPaolo Shqipëri, Banka NBG Shqipëri, Banka ProCredit, Raiffesien Bank Shqipëri, Tirana Bank, Banka Union, Banka e Bashkuar e Shqipërisë dhe Veneto Banka.

2. Baza e Përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me SKK për OJF-të dhe ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. SKK për OJF-të ka hyrë në zbatim nga data 1 janar 2016.

Pasqyrat Financiare paraqiten në Lek (ALL), e cila është dhe monedha funksionale e Shoqatës.

3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

- Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme. Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë si të ardhurat që lidhen me to.

Të ardhurat kryesore të Shoqatës vijnë nga tarifat e anëtarësimit, të cilat janë subjekt i miratimit të Asamblesë së Anëtarëve.

Të ardhurat regjistrohen kur realizohen dhe shpenzimet regjistrohen kur ndodhin.

- Transaksionet në monedhë të huaj

AAB përdor si monedhë bazë Lek-un (ALL). Të gjitha kontributet dhe pjesa dërrmuese e shpenzimeve janë në lekë (ALL). Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin në datën e kryerjes së transaksionit. Të gjitha balancat në monedhë të huaj në fund të vitit janë konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e fundit të vitit si vijon:

Kursi i këmbimit më 31 Dhjetor

	31/12/2016	31/12/2015
Euro	135.23	137.28

Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

Vlerësimi fillestar i elementeve që plotësojnë kriteret e njohjes si AAM në bilanc është bërë me koston e blerjes plus kostot e tjera të drejtpërdrejta, që lidhen me sjelljen e aktivitetit në vendndodhje dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të Shoqatës. Vlerësimi vijues është bërë sipas modelit të koston dhe AAM-të paraqiten në bilanc në vlerën neto (minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e mundshme nga zhvlerësimi, nëse ka). Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes.

Normat e amortizimit dhe metoda sipas grupeve:

	Norma e Amortizimit	Metoda e përdorur
Pajisje Informatike	25%	Vlera e mbetur
Mobilje/Orendi	20%	Vlera e mbetur
AAM të tjera	20%	Vlera e mbetur

- Tatimet dhe Taksat

AAB është një shoqëri jo fitimprurëse dhe, si e tillë, është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore, si dhe taksave vendore.

4. Arka dhe Banka

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

Në Lek	31/12/2016	31/12/2015
Llogari rrjedhëse në lekë	14,571,976	9,258,375
Llogari rrjedhëse në euro	124,193	42,403
Para në arkë	58,925	25,038
Gjithsej	14,755,093	9,325,816

5. Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm

Të drejtat dhe interesi i arkëtueshëm përbëhen nga sa më poshtë:

Në Lek	31/12/2016	31/12/2015
Parapagime	91,377	-
Detyrime të tjera	142,695	-
Garanci qera	280,160	280,160
Gjithsej	514,232	280,160

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

6. 6. Kontribute të arkëtueshme

Kontributet e arkëtueshme përbëhen nga sa më poshtë:

Në Lek	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Tarifa antarësimi	692,750	-
Gjithsej	692,750	-

7. Inventarë dhe shpenzime të parapaguara

Inventarë dhe shpenzime të parapaguara përbëhen nga sa më poshtë:

Në Lek	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Shpenzime interneti	10,918	9,785
AKEP	3,833	4,833
Anëtarësim BACEE	272,100	604,760
Mirëmbajtje dhe hostim web	25,999	30,061
Hostim domain	-	16,816
Siguracion shëndeti	193,900	196,630
Bileta udhëtimi	-	103,386
Gjithsej	506,750	966,270

8. Aktivet e Qëndrueshme

Aktivët e Qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

Në LEK	Mobilje / Orendi	Pajisje Kompjuterike	Gjithsej
Kosto			
Në 31 Dhjetor 2015	1,953,925	1,173,221	3,127,146
Shtesat gjatë vitit 2016	111,766	259,546	371,312
Pakësimi gjatë vitit 2016	(51,990)	(210,000)	(261,990)
Në 31 Dhjetor 2016	2,013,701	1,222,767	3,236,468
Amortizimi i Akumuluar			
Në 31 Dhjetor 2015	1,477,711	925,565	2,403,276
Amortizimi gjatë vitit 2016	73,106	90,013	163,119
Pakësimi gjatë vitit 2016	(45,549)	(198,858)	(244,408)
Në 31 Dhjetor 2016	1,505,267	816,720	2,321,987
Vlera Neto e Librit			
Në 31 Dhjetor 2015	476,214	247,656	723,870
Në 31 Dhjetor 2016	508,434	406,048	914,482

9. Llogari të Pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga sa vijon:

Në Lek	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Furnitorë	672,637	497,656
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	192,456	171,680
TAP	368,174	227,628
Tatim në Burim	72,259	10,120
Personeli	30	-
Gjithsej	1,305,556	934,463

10. Aktivët Neto

Aktivi neto është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të OJF-së në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Ndryshimi në aktivët neto paraqitur në pasqyrën e aktiviteteve artikullohet në aktivët neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar.

Aktivët neto të paraqitura si të pakufizuara përdoren në periudhat vijuese vetëm për objektivat e përcaktuara në statutin e shoqatës.

Në Lek	2016	2015
Në fillim të periudhës	10,361,654	15,821,008
Rritje në aktivët neto	5,716,097	-
Humbjet nga zhvlerësimi	-	(5,459,353)
Vlera e bartur në vitin e ardhshëm	16,077,751	10,361,654

11. Të Ardhurat

Në Lek	2016	2015
Tarifa anëtarësimi nga bankat anëtare	36,984,000	33,000,000
Trajnim bankat anëtare	3,717,480	4,032,055
Interesa kreditore	-	7,884
Gjithsej	40,701,480	37,039,940

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

12. Aktiviteti A – Shpenzime Organizimi

Në Lek	2016	2015
Evente dhe Tryeza pune	6,454,899	2,841,516
Anëtarësime	1,500,645	1,679,200
Udhëtime	679,866	473,946
Trajnime bankat anëtare	3,175,176	4,020,423
Gjithsej	11,810,586	9,015,085

13. Aktiviteti B – Shpenzime promovimi, publikime dhe reklama

Në Lek	2016	2015
Publikime	3,652,851	3,729,631
Materiale informative dhe publicitet	692,260	1,335,326
Gjithsej	4,345,111	5,064,957

14. Aktiviteti C – Konsulenca dhe shërbime këshillimi

	2016	2015
Shërbime ligjore	-	1,157,566
Shërbime financiare	-	780,681
Gjithsej	-	1,938,247

15. Aktiviteti D - Donacione dhe Kontribute

Në Lek	2016	2015
Kontribut për zonat e përmytura	-	6,000,000
Mbështetje me publicitet për fushatën e Qeverisë anti-informalitet	-	2,758,141
Gjithsej	-	8,758,141

16. Shpenzimet e përgjithshme dhe të administrimit

	2016	2015
Paga personeli	11,258,281	9,852,053
Kontribute për sigurime	1,114,606	1,068,640
Sigurim shëndeti	584,430	540,260
Qira	3,300,500	3,357,880
Shpenzime komunikimi	796,369	1,015,053
Shpenzime utilitare	204,668	240,205
Taksa lokale	15,000	10,120
Komisione bankare	82,524	75,671
Shërbime përkthimi	277,462	246,442
Kancelari dhe të tjera të konsumueshme	308,254	533,502
Abonime	191,614	171,381
Noterizime	22,140	14,400
Shpenzime të tjera	472,756	362,780
Diferenca kursi	10,310	33,367
Penalitete	10,071	20,020
Amortizimet dhe zhvlerësimet	180,701	181,088
Gjithsej	18,829,686	17,722,863

Përgatiti:

Elona Bisha
AAP shpk

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Spiro Brumbulli
Sekretar i Përgjithshëm

